

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Gjeodezisë shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë të kategorisë asistent lektor për lëndët Hartografi dixhitale dhe Astronomi në degën e Gjeodezisë.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të jetë diplomuar në degën “Gjeodezi”, në ciklin Master Shkencor ose sistemi i integruar 5 vjeçar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës ose në Universitete Analoge të Huaja (diplomat duhet të jenë njohur nga MAS).
2. Nota mesatare të jetë ≥ 8.0 për ciklet e studimit (Bachelor, Master Shkencor) ose sistemi 5 vjeçar.
3. Të zotërojë një gjuhë të huaj (Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht) me dëshmi apo çertifikatë.
4. Preferohen kandidatët që kanë:
 - a. Tituj shkencorë/akademikë;
 - b. Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit;
 - c. Përvojë pune si personel akademik pranë një Universiteti të njohur zyrtarisht nga MASR;
 - d. Eksperiencë në disiplinën për të cilën konkuron;
 - e. Publikime në formë artikujsh në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit;
 - f. Prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

II. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik me kohë të plotë.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati propozohet të jenë si më poshtë :

1. Të jetë i diplomuar në degën “Inxhinieri Mjedisit” të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit ose në fakultete të tjera në universitete të njohura perëndimore në degën e mësipërme.
2. Të ketë diplomën Master Shkencor, në Inxhinieri Mjedisit ose diplomë e sistemit 5-vjeçar.
3. Të ketë njohuri dhe eksperiencë në kryerjen e proceseve të ndryshme laboratorike, (të dokumentuara me CV dhe vërtetime).
4. Të ketë njohuri në programet kompjuterike në programet word, excel, AUTOCAD etj.
5. Të ketë njohuri në gjuhë të huaja të bashkimit evropian.

III. Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Gjeoshkencave shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë në Departamentin e Meteorologjisë.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

5. Të kenë formim universitar (Bachelor dhe Master i Shkencave) në fushën e Gjeografisë dhe Gjeo-Informatikës.
6. Preferohen kandidatët që kanë diplomë Master i Shkencave në “Gjeo-Informatikë”.
7. Nota mesatare mbi 8.0 (Bachelor + Master i Shkencave).
8. Të kenë njohuri të mira në sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS), menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave (reshjeve, temperaturë, era etj) dhe analizave statistikore.
9. Njohuri të mira të gjuhës angleze, të dokumentuar me dëshmi përkatëse, së paku niveli B2, gjuhët e tjera janë avantazh.
10. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

IV. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **08.03.2024** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.